



N. 274/1 Prot.

Tiranë, më 26 gusht 2021

**Rregullore për transferim të studimeve
në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"
V.Ak. 2021-2022**

Informacion i përgjithshëm

Procedurat e transferimit të studimeve në UKZKM miratohen në përputhje me Urdhrin nr.12, të datës 26/08/2021, publikuar në faqen zyrtare: www.unizkm.al.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 436, të datës 03.06.2020, e ndryshuar me VKM nr.46 të datës 27/01/2021 të Republikës së Shqipërisë për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për vitin akademik 2021-2022, në rastet e transferimit të studimeve në Universitetin tonë, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit të të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM përkatëse të vitit akademik që studentit është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016-2017.

Kandidatët e huaj që nuk e kanë përfunduar arsimin e mesëm në Itali ose në një shkollë të mesme ku gjuha zyrtare e mësimit nuk është gjuha italiane, duhet të kenë Certifikatën e mbrojtjes së gjuhës italiane të paktën në nivelin B1, siç parashikohet në Udhëzimin Nr. 52 datë 03/12/2015, ose të kryejnë testimin mbi njohjen e Gjuhës Italiane të organizuar nga Universiteti Katolik ZKM në momentin e regjistrimit.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen njëkohësisht në disa programe studimi në të njëjtin vit akademik, në universitete publike dhe/ose private, shqiptare dhe/ose të huaja.

Kreu I-Procedurat e transferimit për kandidatët shtetas shqiptarë

1. Si të aplikoni për transferimin e studimeve

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.6, datë 25/06/2021 të QSHA-RASH, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për transferim të studimeve në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të Universitetit Katolik ZKM **nga data 2 shtator deri në datën 13 shtator 2021**. Për të aplikuar për transferim të studimeve në Universitetin Katolik ZKM, kandidatët **duke nisur nga data 2 Shtator 2021** duhet:

- të kryejnë regjistrimin¹ online në Portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>
- të përzgjedhin zërin: "Trasferimento degli studi"
- të plotësojnë procedurën duke ngarkuar online kopje elektronike në format PDF (të skanuara në format pdf/A) dokumentacionin e mëposhtëm për transferimin e studimeve.
 - 1.Kërkesën për transferim drejtuar IAL (e shkarkueshme në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>)
 - 2.Planin e plotë të programit të studimit që ka ndjekur studenti, lëshuar nga Universiteti nga ku transferohet, firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
 - 3.Programet e detajuara të lëndëve të provimeve të shlyera për çdo lëndë të ndjekur firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;

¹ Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

4. Vërtetim në origjinal për studimet e kryera që vërteton provimet e shlyera me notat përkatëse dhe kreditet e fituara (ECTS) firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
5. Diplomën e Maturës Shtetërore;
6. Çertifikatën e Maturës Shtetërore;
7. Kartë identiteti ose pasaportë.

Shënim: Nëse dokumentacioni i mësipërm nuk është në gjuhën italiane, duhet të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet përpara se të ngarkohet në Portalin e Universitetit.

2. Procedurat e transferimit

- Për programet e studimit në Mjekësi, Odontoiatri dhe Proteza Dentare, Fizioterapi dhe Infermieristikë:

Kandidatët që kanë ngarkuar dokumentacionin e plotë/të rregullt në Portalin e pranimeve: <http://admissions.unizkm.al/> dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare (sipas V.K.M nr.463, dt. 03/06/2020) do të vlerësohen paraprakisht për studimet universitare të kryera më parë. Nëse gjatë këtij procesi verifikimi, kreditet e fituara në programin nga vjen rezultojnë të mjaftueshme për të transferuar të paktën 30 kredite në programin ku aplikon për transferim, kandidatët do të konsiderohen "Kandidatë që kualifikohen për procesin e transferimit" dhe **duhet të kryejnë testimin e pranimit** pranë UniZKM për kuotat e parashikuara për transferim në programet e Studimit dhe datat e mëposhtme:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në Mjekësi dhe Kirurgji	24/09/2021	11:00
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në Odontoiatri dhe Proteza Dentare	24/09/2021	14:00
Programi i studimit në Fizioterapi	24/09/2021	16:00
Programi i studimit në Infermieristikë	24/09/2021	16:00

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara në testimet e mëposhtme dhe nga vlerësimi i mesatares së përgjithshme së shkollës së mesme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali	80 pikë

Transferimi i studimeve në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit Katolik ZKM u lejonet studentëve që vijnë nga programe studimi të të njëjtit cikël dhe së njëjtës fushë studimi të universiteteve publike shqiptare dhe universiteteve publike dhe private të huaja, të licensuara dhe të akredituara në vendet e origjinës në momentin e aplikimit për transferim.

Pranohen pa kryer testimin e pranimit dhe kanë përparësi në listën e renditjes së aplikantëve duke u renditur sipas kriterit të mesatares së ponderuar të provimeve të dhëna në Universitetin e origjinës, kandidatët që vijnë nga programe



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

të njëjta studimi nga Universitete të Bashkimit Evropian, të njohura nga Universiteti ynë, sipas marrëveshjeve me Universitetin partner italian për transferim direkt të studimeve.

-Në programet e studimit në Arkitekturë, Ekonomi Ndërmarrjeje dhe Farmaci:

Dokumentacioni i kandidatëve që paraqesin kërkesë transferimi për këto programe studimi do t'i depozitohet Komisionit Didaktik *ad hoc* për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara nga mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme dhe studimeve universitare të kryera më parë:

1.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	50 pikë
2.	Studimet universitare të kryera më parë (Kredite të njohura)	50 pikë
	Totali	100 pikë

Shënim: Kandidatët që nuk kanë të paktën 30 kredite të njohura në programin ku aplikojnë për transferim **nuk mund të vijojnë procedurat e transferimit** në Universitetin Katolik ZKM.

3. Tarifat

Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve duhet të paraqiten pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit², për të paguar tarifat e mëposhtme:

1. Brenda datës 13 shtator 2021, ora 16:30 për tarifën e parashikuar për të aplikuar për transferim të studimeve:

- 50 Euro nga Universitete të tjera drejt Universitetit Katolik ZKM;
- 20 Euro nga një program tjetër studimi brenda Universitetit Katolik ZKM;

2. Brenda datës 21 shtator 2021, ora 16:30 për tarifën e regjistrimit për testim (për kandidatët që duhet të kryejnë testimin e pranimit): 2.000 Lekë.

Po ashtu, pagesa tarifave të mësipërme mund të kryhet edhe me kartë krediti në Portalin e Universitetit : admissions.unizkm.al.

4. Listat e renditjes

Listat e renditjes së aplikantëve do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” <https://www.unizkm.al/>. Kandidatët mund të përjashtohen nga lista e renditjes nëse gjenden parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për aplikim.

5. Procesi i regjistrimit

² Hapur nga e Hëna në të Premte ora 08:00-16:00 dhe ditën e Shtunë ora 08:00-13:00.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.6, datë 25/06/2021 të QSHA-RASH, kandidatët e shpallur fitues në bazë të rezultateve dhe kuotave të parashikuara, duhet të kryejnë regjistrimin nga data **7 deri me datë 11 Tetor 2021**, duke dorëzuar pranë Sekretarive Mësimore përkatëse dokumentacionin e mëposhtëm:

- 5.1 Planin e studimit të programit të studimit të ndjekur nga kandidati në Universitetin nga vjen, firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
- 5.2 Programet e detajuara të provimeve të dhëna dhe lëndëve të ndjekura firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
- 5.3 Vërtetim origjinal për studimet e kryera që certifikon provimet e shlyera me notat përkatëse dhe kreditet e fituara (ECTS) firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet; **Dokumentacioni i cituar në pikën 5.1, 5.2 dhe 5.3 duhet të jetë origjinal apo fotokopje e noterizuar, i pajisur me vulë Apostile. (Vula Apostile kërkohet vetëm në rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj). Dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin përfundimtar duhet të jetë identik me versionin elektronik të përdorur në regjistrimin për konkurs.**
- 5.4 Mandatin e kryerjes së pagesës së kështit të parë apo të kështit të plotë të tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studentit, zëri "Tariffe");
- 5.5 Diplomën e Maturës Shtetërore (origjinale) dhe fotokopjen e noterizuar të saj;
- 5.6 Certifikatë e Maturës Shtetërore në origjinal bashkë me fotokopjen e noterizuar të saj;
- 5.7 Vërtetim banimi;
- 5.8 Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të ndjekur studimet;
- 5.9 Certifikatë familjare;
- 5.10 Dy foto personale për dokument.
- 5.11 Dokumenti i njehsimit³ të Diplomës së Maturës Shtetërore lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë origjinale ose kopje të noterizuar (vetëm për kandidatët që e kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit). Për ata që nuk janë pajisur me dokumentin e Njehsimit nga kjo Qendër, **qëndron detyrimi** ta paraqesin këtë dokument **brenda datës 15 dhjetor 2021** dhe në çdo rast përpara fillimit të sezonit dimëror të provimeve.
- 5.12 Dokumenti i Çregjistrimit nga Universiteti nga ku transferohet.

Universiteti Katolik "ZKM" ka të drejtën të verifikojë vërtetësinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga kandidati me Institucionin e Arsimit të Lartë nga ku kërkon të transferohet, përpara se të regjistrojë studentin në programin përkatës.

Kandidatët të cilët do të kenë mangësi në dorëzimin e dokumentit të cituar në pikën 5.11 do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë. Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studentit: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit;

³ Informacionet se si mund të pajiseni me dokumentin e njehsimit të Diplomës së Maturës Shtetërore gjenden në faqen e internetit: <http://unizkm.al/>



Kreu II-Procedurat e transferimit për kandidatët shtetas të huaj

1.Si të aplikoni për transferimin e studimeve

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.6, datë 25/06/2021 të QSHA-RASH, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për transferim të studimeve në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të Universitetit Katolik ZKM nga data 2 Shtator deri në datën 13 Shtator 2021.

Për të aplikuar për transferim të studimeve në Universitetin Katolik ZKM, kandidatët **duke nisur nga data 2 Shtator 2021** duhet:

- të kryejnë regjistrimin⁴ online në Portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>
- të përzgjedhin zërin: “**Trasferimento degli studi**”
- të plotësojnë procedurën duke ngarkuar online kopje elektronike në format PDF (të skanuara në format pdf/A) dokumentacionin e mëposhtëm për transferimin e studimeve:
 1. Kërkesën për transferim (e shkarkueshme në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>)
 2. Planin e plotë të programit të studimit që ka ndjekur studenti, lëshuar nga Universiteti nga ku transferohet, firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
 3. Programet e detajuara të lëndëve të provimeve të shlyera për çdo lëndë të ndjekur firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
 4. Vërtetim në origjinal për studimet e kryera që vërteton provimet e shlyera me notat përkatëse dhe kreditet e fituara (ECTS) firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
 5. Diplomën e Maturës Shtetërore;
 6. Certifikatën e Diplomës së Maturës Shtetërore me të dhënat përkatëse (provimi me shkrim, provimi me gojë, kreditet, pikët shtesë), që përbëjnë vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore;
 7. Dëftesat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
 8. Kartë identiteti ose Pasaportë.
 9. Kryerjen e pagesës prej 50€ për aplikimin për regjistrim⁵ (pagesa kryhet me kartë krediti në të njëjtin portal: <http://admissions.unizkm.al/>)

Shënim: Nëse dokumentacioni i mësipërm nuk është në gjuhën italiane, duhet të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet përpara se të ngarkohet në Portalin e Universitetit.

2. Procedurat e transferimit

- Për programet e studimit në Mjekësi, Odontoiatri dhe Proteza Dentare, Fizioterapi dhe Infermieristikë:

Kandidatët që kanë ngarkuar dokumentacionin e plotë/të rregullt në Portalin e pranimeve: <http://admissions.unizkm.al/> dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare (sipas V.K.M nr.463, dt. 03/06/2020) do të vlerësohen paraprakisht për studimet universitare të kryera më parë. Nëse gjatë këtij procesi verifikimi, kreditet e fituara në programin nga vjen rezultojnë të mjaftueshme për të transferuar të paktën 30 kredite në programin ku aplikon për transferim, kandidatët do

⁴ Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>

⁵ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.



**UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË**

të konsiderohen “Kandidatë që kualifikohen për procesin e transferimit” dhe **duhet të kryejnë testimin e pranimit** pranë UniZKM për kuotat e parashikuara për transferim në programet e Studimit dhe datat e mëposhtme:

➤ **Për kandidatët që vijnë nga vendet e BE** testimet e pranimit do të kryhen në datat:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	29/09/2021	11:00
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	29/09/2021	11:00
Program i studimit në <i>Fizioterapi</i>	30/09/2021	11:00
Program i studimit në <i>Infermieristikë</i>	30/09/2021	11:00

Vlerësimi i kandidatëve që vijnë nga vendet e BE bëhet në bazë të pikëve përfundimtare të grumbulluara në testimet e mëposhtme dhe nga vlerësimi i mesatares së përgjithshme së shkollës së mesme:

1.	Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	60 pikë
2.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali		90 pikë

Brenda datës 21 shtator 2021, kandidatët nga vendet e BE-së që konsiderohen të kualifikuar për procesin e transferimit dhe të cilët do të marrin pjesë në testimet e pranimit në Programet e Studimit të Fakultetit të Mjekësisë do të duhet të **paguajnë tarifën prej 100 euro⁶ për pjesëmarrjen në testimin e pranimit** (pagesa kryhet me kartë krediti në të njëjtin portal: <http://admissionions.unizkm.al/>).

➤ **Për kandidatët që vijnë nga vendet jo-BE** testimet e pranimit do të kryhen në datat:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	24/09/2021	11:00
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në <i>Odontoiatri dhe Proteza</i>	24/09/2021	14:00

⁶ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Dentare		
Programi i studimit në <i>Fizioterapi</i>	24/09/2021	16:00
Programi i studimit në <i>Infermieristikë</i>	24/09/2021	16:00

Vlerësimi i kandidatëve nga vendet jo-BE bëhet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali	80 pikë

Brenda datës 21 shtator 2021, kandidatët nga vendet jo-BE që konsiderohen të kualifikuar për procesin e transferimit dhe të cilët do të marrin pjesë në testimet e pranimit në Programet e Studimit të Fakultetit të Mjekësisë do të duhet të **pagojnë tarifën prej 100 euro⁷ për pjesëmarrjen në testimin e pranimit** (pagesa kryhet me kartë krediti në të njëjtin portal: <http://admissionions.unizkm.al/>).

Testimet e pranimit do të zhvillohen në selinë e Universitetit Katolik "ZKM" në Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri. Nëse ka ndonjë ndryshim për shkak të emergjencës Covid-19, kandidatët do të informohen në kohë.

Shënim: Pranohen pa kryer konkursin e pranimit dhe kanë përparësi në listën e renditjes së aplikantëve duke u renditur sipas kriterit të mesatares së ponderuar të provimeve të dhëna në Universitetin e origjinës, kandidatët që vijnë nga programe të njëjta studimi nga Universitete të Bashkimit Evropian, të njohura nga Universiteti ynë, sipas marrëveshjeve me Universitetin partner italian për transferim direkt të studimeve.

-Në programet e studimit në Arkitekturë, Ekonomi Ndërmarrjeje dhe Farmaci:

Dokumentacioni i kandidatëve që paraqesin kërkesë transferimi për këto programe studimi do t'i depozitohet Komisionit Didaktik *ad hoc* për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara nga mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme dhe studimeve universitare të kryera më parë:

1.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	50 pikë
2.	Studimet universitare të kryera më parë (Kredite të njohura)	50 pikë
	Totali	100 pikë

⁷ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.



Shënim: Kandidatët që nuk kanë të paktën 30 kredite të njohura në programin ku aplikojnë për transferim, do të konsiderohen "Kandidatë të pakualifikuar për procesin e transferimit" dhe do të kenë mundësinë për t'u regjistruar në vitin e parë nëse deklarohen të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit dhe Notës Mesatare sipas indikacioneve të Njoftimit përkatës për pranimin në vitin e parë.

3. Listat e renditjes

Listat e renditjes së aplikantëve do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM: <https://www.unizkm.al/>. Kandidatët mund të përjashtohen nga lista e renditjes nëse gjenden parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim.

4. Procesi i regjistrimit

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.6, datë 25/06/2021 të QSHA-RASH, kandidatët e shpallur fitues në bazë të rezultateve dhe kuotave të parashikuara, duhet të kryejnë regjistrimin nga data **7 deri me datë 11 Tetor 2021**, duke dorëzuar pranë Sekretarive Mësimore përkatëse dokumentacionin e mëposhtëm:

- 4.1 Planin e studimit të programit të studimit të ndjekur nga kandidati në Universitetin nga vjen, firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
- 4.2 Programet e detajuara të provimeve të dhëna dhe lëndëve të ndjekura firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet;
- 4.3 Vërtetim në origjinal për studimet e kryera që certifikon provimet e shlyera me notat përkatëse dhe kreditet e fituara (ECTS) firmosur dhe vulosur nga Sekretaria Mësimore e Universitetit nga ku transferohet; **Dokumentacioni i cituar në pikën 4.1, 4.2 dhe 4.3 duhet të jetë origjinal apo fotokopje e noterizuar, i pajisur me vulë Apostile. Dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin përfundimtar duhet të jetë identik me versionin elektronik të përdorur në regjistrimin për konkurs.**
- 4.4 Mandatin e kryerjes së pagesës së kështit të plotë të tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti, zëri "Tariffe");
- 4.5 Diplomën e Maturës Shtetërore origjinale dhe *fotokopjen e noterizuar të saj*;
- 4.6 Dëftesat e gjithë viteve të Shkollës së Mesme origjinale dhe *fotokopjen e noterizuar të secilës prej tyre*.
- 4.7 Certifikatën e Diplomës së Maturës Shtetërore firmosur dhe vulosur nga gjimnazi/shkolla e mesme, me të dhënat përkatëse (provimi me shkrim, provimi me gojë, kreditet, pikët shtesë) që përbëjnë vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore në origjinal dhe *fotokopjen e noterizuar të saj*;
- 4.8 Vërtetim banimi;
- 4.9 Vërtetim i Gjendjes Gjqësore (e domosdoshme për lejen e qëndrimit);
- 4.10 Certifikatë penale (e domosdoshme për lejen e qëndrimit);
- 4.11 Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të ndjekur studimet;
- 4.12 Dy foto personale për dokument.
- 4.13 Dokumenti i njehsimit⁸ të Diplomës së Maturës Shtetërore lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë origjinale ose kopje të noterizuar. Për ata që nuk janë pajisur me dokumentin e Njehsimit nga kjo Qendër, **qëndron** detyrimi ta paraqesin këtë dokument **brenda datës 15 dhjetor 2021** dhe në çdo rast përpara fillimit të sezonit dimëror të provimeve.
- 4.14 Dokumenti i Çregjistrimit nga Universiteti nga ku transferohet.

⁸ Informacionet se si mund të pajiseni me dokumentin e njehsimit të Diplomës së Maturës Shtetërore gjenden në faqen e internetit: <https://unizkm.al/>



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Universiteti Katolik “ZKM” ka të drejtën të verifikojë vërtetësinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga kandidati me Institucionin e Arsimit të Lartë nga ku kërkon të transferohet, përpara se të regjistrojë studentin në programin përkatës.

Shënim: Ju kujtojmë se shtetasit e huaj mund të qëndrojnë lirisht në Shqipëri për një periudhë maksimale prej 90 ditësh në një gjashtëmujor (gjashtëmujori llogaritet nga dita e hyrjes së parë në vend dhe 90 ditët llogariten duke shtuar të gjitha periudhat e qëndrimit në Shqipëri, edhe nëse jo të njëpasnjëshme). Ata që synojnë të qëndrojnë në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë në një gjashtëmujor, duhet të paraqesin kërkesë për leje qëndrimi pranë autoriteteve kompetente shqiptare dhe duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore një kopje të noterizuar të lejes së qëndrimit në Shqipëri.

Kandidatët të cilët do të kenë mangësi në dorëzimin e dokumentit të cituar në pikën 4.13 do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë. Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali student: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit.

Raktori

Prof. Bruno Giardina

